



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës, 01-Nr-016-7790, të datës 30.01.2019, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.01.2019, miratoi këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës, në këtë përbërje:

- 1.1. Marigona Gashi-----anëtare
- 1.2. Elmaze Bytyçi-----anëtare
- 1.3. Gazmend Gashi -----anëtar
- 1.4. Sahadete Kuçi-----anëtare
- 1.5. Agim Rraqi-----anëtar

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bënë shqyrtimin dhe selektimin e aplikacioneve që kanë konkurruar për bursa për student/e dhe nxënës/ dhe të ju ndanë bursa atyre që e meritojnë dhe i plotësojnë kushtet dhe kriteret konform dispozitave të Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës, me numër të protokollit 01-Nr-016-7790, të datës 30.01.2019.

Neni 3


3.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË



Kryesuesi i Kuvendit
Bexhet KUÇI

01-Nr-016-7819
Me datë 31.01.2019